



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/22  
Datë: 03.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-080, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 gusht 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për Drejtorë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
  - 1.1. Nazmi Mikullovc, Kryesues;
  - 1.2. Syzana Dautaj - Surdulli;
  - 1.3. Mentor Hyseni;
  - 1.4. Vjollca Jashari;
  - 1.5. Violeta Arifi - Krasniqi;
  - 1.6. Xhevdet Neziraj;
  - 1.7. Halim Muçolli;
  - 1.8. Avni Ajdini.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë e të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë